



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:264979
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05622733

PA1.nr.192/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Skender Çoçaj - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarve M. B. dhe S. B. , që të dy nga P, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31, të KPRK-së të akuzuarit R. M. , nga P, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe të akuzuarit A. M. , nga P, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale Lëndim i rëndë trupor, nga neni 186 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 pika 1.3 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së të Prokurorisë Themelore në Prizren, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1339/23, datë 26.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 25.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1339/23, datë 26.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin P.nr.1339/23, datë 26.12.2023, të akuzuarit M. B. dhe S. B. i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31, të KPRK-së të akuzuarit R. M. , për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe të akuzuarit A. M. , për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale Lëndim i rëndë trupor, nga neni 186 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 pika 1.3 të KPRK-së i ka gjykuar me dënim me gjobë dhe atë, të akuzuarit M. B. , për veprën penale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me gjobë, në shumën prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) €. Të akuzuarit S. B. për veprën penale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me gjobë, në shumën prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) €. Të akuzuarit R. M. për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me gjobë, në shumën prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) €. Të akuzuarit A. M. për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me gjobë, në shumën prej 850 (tetëqind e pesëdhjetë) €, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak, nga data 02.12.2023 e deri me datën 26.12.2023 gjithsej 24 ditë, ashtu që i akuzuari është i obliguar që ta paguaj dënimin me gjobë (mbetje) në shumën prej 370 (treqind e shtatëdhjetë) €. Të akuzuarit janë të obliguar që dënimin me gjobë në shumën e lartcekur ta paguajnë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në qoftë se të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë në mënyrën e lartcekur, atëherë mundësia e pagesës së dënimit me gjobë do të revokohet. Nëse të akuzuarit nuk mund apo nuk dëshirojnë ta paguajë dënimin me gjobë në shumën e lartcekur, atëherë gjykata konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € llogaritet 1 (një) ditë burgim. Si dhe iu ka shqiptuar dënim me kusht dhe atë të akuzuarit A. M. për veprën penale si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me kusht, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej dy (2) viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Në qoftë se i akuzuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënim me burgim prej dy (2) apo më tepër vjet i njëjti do të revokohet. I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil-juridik. Në kuptim të nenit 276 par.1 dhe 2 të KPRK-së, nga i akuzuari konfiskohet një (1) gyp metalik. Janë të obliguar të akuzuarit që secili veç e veç ti kompensoj shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare, duke përfshirë të gjitha shpenzimet, kurse në emër të ekspertizës mjeko-ligjore për tre persona të gjithë së bashku shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20 (njëzet) €, si dhe për fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzet) €, të gjitha këto, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor. Urdhërohet Shërbimi Sprovues i Kosovës-dega në Prizren, që të bëjë mbikëqyrjen e dënimit me kusht.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit mbi sanksionin penal, duke i propozuar Gjykatës

së Apelit të Kosovës, ankesën të e aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarve të iu shqiptoj dënim me burg efektiv.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.201/24, të datës 08.02.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e prokurorit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve të iu shqiptohet dënim me burg efektiv.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- Ankesa është e pabazuar.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke pretenduar që pjesa ndëshkuese e aktgjyimit të ankimuar është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyet e paraqitura në arsyetim. Dispozitivi i aktgjyimit është i pa qartë, i pa kuptueshëm me arsyetimin lidhur me faktet vendimtare, ku në dispozitiv saktësisht përshkruhen veprimet inkriminuese të të akuzuarve. Gjykata nuk i ka marrë për bazë rrethanat rënduese të të akuzuarve, shkallën e lartë të dashjes nga ana e të akuzuarve, sepse me shqiptimin e këtyre dënimeve nuk janë vlerësuar drejtë rrethanat rënduese, ndërsa rrethanë lehtësuese është marr fakti se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, kërkim faljen, pendimin për rastin që ka ndodhur dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisin veprime të tilla, pra duke i mbi vlerësuar si rrethana që kanë ndikuar në zbutjen në atë masë të dënimit. Andaj kjo bënë që aktgjykimi të jetë përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.2 nënpar.2.7, në lidhje me nenin 369 par.8 të KPRK-së.

Kolegji Penal i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e lartë cekura të prokurorit nuk qëndrojnë dhe janë të pa bazuara. Ngase aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkeljet e pretenduara e gjithashtu nuk përmban as shkelje tjera për të cilat Kolegji Penal i kësaj gjykate përkujdeset sipas detyrës zyrtare konform të dispozitës së nenit 394 të KPP-së. Aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në kuptim të dispozitës së nenit 369 të KPP-së, aktgjykimi është i kuptueshëm dhe është në harmoni dispozitivi me arsyetimin e aktgjyimit. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar edhe Ligjin Penal me rastin e matjes dhe përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjyimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen faktike, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, duke pretenduar që gjykata

pavarësisht faktit se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, atyre iu ka shqiptuar sanksion tejet të butë, me të cilin nuk mund të arrihet qëllimi i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, siç është të i parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. I propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesën të e aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarve të iu shqiptoj dënim me burg efektiv.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e prokurorit, për shqiptimin e një dënimi burgim efektiv, ndaj të akuzuarve, janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi me burgim efektiv, ndaj të akuzuarve. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit e duke u bazuar konform të dispozitës së nenit 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK, gjykata si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, pendimin për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe premtimin se nuk do të përsërisin veprime të tilla kundërligjore. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori për bazë, veprën penale të kryer, niveli i dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyrën e kryerjes së veprës penale, shkallën e lartë të dashjes, ku të akuzuarit me dashje janë përfshirë në kryerjen e veprës penale duke i shkaktuar lëndime trupore njëri tjetrit. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarit dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindjen se edhe me një dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e prokurorit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohen dënime tjera nga ato të cilat iu ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që akuzuarve të iu shqiptoj dënime me burgim efektiv, sikurse që pretendohet në ankesë, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimeve nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve janë në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutorë dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.192/24, më datë 25.04.2024

Zyrtarja ligjore;
Rrezarta Bala

Kryetari i kolegjit
Abdullah Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Skender Çoçaj